

Përshëndetje,

Në lidhje me kërkesën tuaj për numrin e të sëmurëve me sëmundje obstruktive kronike të mushkërive në Tiranë, për periudhën 2012-2022, ju bëjme me dije se:

Deri në vitin 2017 plotësimi i recetave me rimbursim për pacientët është bërë në mënyrë manuale, sipas formatit letër dhe jo përmes sistemit të recetës elektronike. Për këtë arsye nxjerrja e të dhënave që ju kërkoni, për periudhën 2012-2017 kërkon kohë, në mënyrë që të bëhet numërimi manual i recetave.

Në vitin 2017 në rajonin Tiranë është implementuar programi i recetës elektronike dhe bazuar në të dhënat e nxjerra nga ky sistem rezulton se numri i recetave të lëshuara për pacientët me sëmundje obstruktive kronike të mushkërive në Tiranë është mesatarisht 4.500 pacientë në vit.